

VENDIM
Nr.69, datë 12.12 .2007

**PËR SHQYRTIMIN E TRANSFERIMIT TË LICENCËS NGA SHOQËRIA “HCA” SHPK TE
SHOQËRIA “BALKAN GREEN ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22. 5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.467, datë 3.10.2002 “Për miratimin e kontratës koncensionare të formës ROT ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Ekonomisë nga njëra anë dhe shoqërisë italiane “Essegei” s.r.l nga ana tjetër për HEC-et vendore”, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007 “Rregullore e procedurave të licencimit” neni 12, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003, pikat 1.3 dhe 1.4 të kushteve të licencës, Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 7.12.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. për transferimin e licencës së dhënë nga ERE shoqërisë “HCA” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Licenca me nr.13, seria PV03K, datë 19.12.2003, dhënë shoqërisë “HCA” sh.p.k. t’i transferohet shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k.

2. Shoqëria “Balkan Green Energy” sh.p.k. mbart të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në licencën e prodhimit të energjisë elektrike nr.13, seria PV03K, datë 19.12.2003, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.20, datë 19.12.2003.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta